

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	A mund të lirohet apo t'i zbutet masa e sigurisë dikujt që nuk pranon të gjykohe?
ADRESA	https://www.cna.al/aktualitet/a-mund-te-lirohet-apo-ti-zbutet-masa-e-sigurise-dikujt-qe-nuk-pranon--i474089
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 09:29:31 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 09:13:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	31c692b297b8f42f67e7d766adf1272abdbd4db7caf7de7a181c50c3c3f1414b
TEKSTI	d41430260907ae775f92214952844b4906e110b64dd00e872950f173f0830e98
PAMJA	6fd5d959c119d151ec77c7a6d888f68140f266060a87a4221acbcfbfd0ac6055

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	86f8cfa740181c7b447d49b02ed17ade86525e7705951a0bf60b8b0d5cdb23ef
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	e4ff47e3158deeff08239dfd88de708dba9085a414711b421c21bd29dcd303ca
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/86f8cfa740181c7b447d49b02ed17ade86525e7705951a0bf60b8b0d5cdb23ef>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x

11:13 Aktualitet

Ky titull është thelbi i përgjigjes që pritet të merret ng...

A mund të lirohet apo t'i zbutet masa e sigurisë dikujt që nuk pranon të gjykohet?



14 Shtator 2026, 11:13, Aktualitet CNA



Ky titull është thelbi i përgjigjes që pritet të merret nga vendimi i Gjykatës së Lartë nesër për kryebashkiakun e arrestuar të Tiranës, Erion Veliaj. Ndaj tij rëndojnë 13 akuza të rënda penale: "Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë, kryer në bashkëpunim", (9 herë), "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, kryer në bashkëpunim, më shumë se një herë", "Refuzimi për deklarim, mosdeklarim, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur ose nëpunësve publikë", "Shpërdorim detyre", "Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë", "Fshehja e të ardhurave", "Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës", etj., parashikuar nga nenet 260-25, 287/2, 324/a/2, 257/a/2, 248, 180/1, 245, 301, 305/b të Kodit Penal.



Skandali 'Veliaj', 13 akuzat që flasin vetë

Këtu kemi renditur akuzat dhe veprat penale të kryera nga Erion Veliaj. Nuk do t'i hyjmë fare debatit nëse është arrestuar me të drejtë apo pa të drejtë, sepse janë të gjitha vendimet e të gjitha niveleve të gjykatave që e lënë në arrest. Nuk do t'i hyjmë fare diskutimit a ka thënë Gjykata Kushtetuese të lirohet apo të mos lirohet, sepse përgjigjja është shumë e thjeshtë: po të ishte ashtu do të lirohej, Gjykata Kushtetuese do t'i thoshte "lirojeni".



Gjykata Kushtetuese urdhëron Gjykatën e Lartë të bindë Veliajn pse duhet të rrijë në burg

Ajo që duhet theksuar është fakti se: prej korrikut të vitit 2024, dosja e Erion Veliajt me gjithë veprat e sipërpërmendura, me 60 mijë faqe dokumente, fakte dhe prova është çuar në gjykatë. Prej 14 muajsh, Erion Veliaj nuk pranon të gjykohej. Thelbi i përgjigjes që pritet nga Gjykata e Lartë është: A duhet të dalë nga paraburgimi dikush që prej muajsh nuk shkon të gjykohej? Pra, refuzon gjykimin. Nuk paraqitet në gjykatë, por përdor instrumentet e shtyrjes, jurisprudenca e Strasburgut është e qartë në parim: vonesat që i atribuohen vetë të pandehurit dhe mbrojtjes së tij nuk i ngarkohen shtetit. Kush e prodhon vetë zvarritjen, nuk mund ta paraqesë pastaj kohëzgjatjen si provë persekutimi..



Erion Veliaj nuk do që të gjykohej

Erion Veliaj prej 14 muajsh nuk shkon në gjyq, nuk pranon të gjykohej. *Si mund ta lirojë Gjykata e Lartë kur ai nuk gjykohej në arrest? Çfarë ndodh me këtë individ me një masë tjetër sigurie më të butë?*

Erion Veliaj jo vetëm nuk pranon të gjykohej, por do të kthehet dhe në detyrë si kryetar bashkie. Nuk kërkon për shembull, një masë tjetër sigurie si detyrim paraqitje apo arrest shtëpie duke dhënë dorëheqjen.


Jo, kërkon të dalë nga burgu e të kthehet në detyrë. Pse? E ka braktisur fare dhe familjen, dhe qytetarin, dhe individin?! Do të kthehet në detyrë thjesht dhe vetëm që të mos ketë proces gjyqësor, që të prishen provat, siç u kapën duke i prishur Klotilda Bushka me shokë.



E vërteta e Klotilda Bushkës në gjyqin ndaj Veliajt

Një njeri që prej 14 muajsh është në paraburgim dhe nuk shkon të gjykohej, a mund të gjykohej dhe të kemi drejtësi kur ai është në detyrë si kryetar bashkie me gjithë bëmat dhe gjëmat e tij? Kujtojmë këtu sulmet ndaj prokurorëve, sulmet ndaj gjyqtarëve, prishjen e provave. Çfarë do t'u ndodhte dëshmitarëve në qoftë se Erion Veliaj do të ishte në detyrë? Ky është thelbi i përgjigjes që duhet të japë Gjykata e Lartë./CNA

- Reforma në Drejtësi "dështoi" kur u shkoi te dera 'Ndregrave'
- Pse Gjykata e Lartë nuk duhet ta lirojë nga burgu Erion Veliajn?





Të sugjeruara

Seanca në GJKKO, shtyhet gjyqi për dosjen “Partizani”

Nisja e vitit shkollor/ Hita mesazh urimi: Na priftë e mbara! Për sigurinë tuaj nuk bëjmë kompromis

Foto/ Nis viti i ri shkollor, nxënësit me lule e libra nëpër duar

Viti i ri shkollor sjell trafik të rënduar në Tiranë

GJKKO shqyrton sot zëvendësimin e masës së sigurisë së Metës

Viti i ri shkollor/ Rama dhe Kumbaro urojnë nxënësit

AKEP ndalon klauzolat e indeksimit, rritja e çmimit të celularëve duhet të parashikohet në vlerë

BE ka dhënë 1.1 milionë leje qëndrimi për shqiptarët/ Në Gjermani numri arrin rekordin e 124 mijë lejeve

"Gjuhë intimiduese ndaj një gjyqtari"/ Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve del me deklaratë

Plarent Ndreca dhe revolucion i madh i Abetares

"Puçi kushtetues i Kushtetueses"/ Gazetari: Puna e pagave të gjyqtarëve është palaçollëk

Dita e 106-të e protestës/ Qytetarët përsërisin thirrjet kundër qeverisë

Reforma në Drejtësi "dështoi" kur u shkoi te dera 'Ndregrave'

"Bujqësia ka humbur mbi 300 milionë euro ndihma"/ Meta: Ky është shqetësimi i shqiptarëve, jo pagat e gjyqtarëve

Goli 8.6 milionë dollarë i Ron Yeffet edhe me këmbën e narkogjatësisë?

Si po përdoret IA-ja për sigurinë në shkollat e Shqipërisë

E diela para Lartësimit të Kryqit/ Kryepiskopi Joan: Sprovat e jetës duhen parë si mundësi shërimi

Përplasja për pagat e magistratëve/ Rama: Të gjithë të respektojnë Kushtetutën

Shuhen vatrat e zjarrit në të gjithë vendin

Gjergj Luca, sipërmarrësi që ngre qytete/ Fish City Apollonia, një ëndërr e bërë realitet
[editorial](#)

09:41 Editorial

Drejtësia shqiptare dhe katër të vërtetat që askush s'i thotë bashkë

CNA LIVESTREAM





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.